



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:114057
Datë: 05.03.2024
Numri i dokumentit: 05523216

AN.nr.16/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Delushe Halimi, kryetare e kolegjit, Ramiz Kuqi dhe Hajriz Hoti anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit N. I., të cilin me autorizim e përfaqëson avokat J. O. nga P., kundër të paditurës Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike sh.a (KEDS) në Pejë, me bazë juridike: rikthim i humbjeve, duke vendosur lidhur me konfliktin e kompetencës në mes të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 05.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Për gjykim në çështjen e paditësit N. I., nga P., kundër të paditurës Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike sh.a në Pejë, Distribucioni në Pejë, është kompetente lëndore dhe territoriale, Gjykata Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm, të cilës i dërgohen shkresat e lëndës në veprim të mëtejme.

A r s y e t i m

Paditësi N. I., nga P., me datë 28.05.2019, ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, kundër të paditurit KEDS, për shkak të anulimit të faturës dhe rikthimit të humbjeve. Gjykata Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil me aktvendimin C.nr.606/19, i datës 11.06.2019, shpallet jo kompetente lëndore për të vendosur në këtë çështje dhe lëndën ia dërgon Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamentit për Çështje Administrative, si gjykatë me kompetencë lëndore.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative, me aktvendimin A.nr.222/2024, të datës 06.02.2024, hap konfliktin e kompetencës duke u bazuar në nenin 24 të LPK-së, pasi që vlerëson se në rastin konkret pikërisht Gjykata Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, është kompetente për të vendosur në këtë çështje juridike. Këtë bindje Gjykata e krijoj duke u bazuar në atë se, paditësi me padinë e tij nuk ka kërkuar anulimin e ndonjë akti administrativ, të nxjerrë në procedurë administrative të ndonjë organi

administrativ. Ngase në bazë të nenit 13.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, është përcaktuar se “Konflikti administrativ mund të filloj vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative të shkallës së dytë. Gjithashtu, me nenin 13 par.2 përcaktohet se “Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë kundër të cilit në procedurë administrative ankimi është i lejuar”. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe analizimit të fakteve me kompetencën lëndore dhe territoriale, vlerëson se, kompetente për gjykimin e kësaj çështje juridike është Gjykata Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, pikërisht në procedurë kontestimore, për shkaqet në vijim: Në procedurën e konfliktit administrativ, sipas Ligjit për Konfliktet Administrative, nuk mund të jetë palë e paditur një person fizik apo juridik, i cili nuk paraqitet në cilësinë e organit të administratës shtetërore të nivelit qendror dhe lokal. Gjykata vlerëson se nga vetë kërkesëpapia e paditësit shihet se, i njëjti ka kërkuar nga gjykata që të anulohet vendimi i KEDS-it, për kthimin e humbjeve prej 42.369 euro, pa bazë prandaj kjo çështje nuk ka të bëjë me konflikt administrativ.

Gjykata e Apelit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës lidhur me konfliktin e kompetencës në mes të Gjykatës Themelore, në Prishtinë dhe Gjykatës Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm, gjeti se e kompetencës lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike kontestuese është Gjykata Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm, pasi që paditësi me padinë e tij ka kërkuar të anulohet vendimi i KEDS-it, i cili nuk është organ shtetëror, ngase në bazë të nenit 13.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, është përcaktuar se “Konflikti administrativ mund të filloj vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative të shkallës së dytë. Gjithashtu, me nenin 13 par.2 përcaktohet se “Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë kundër të cilit në procedurë administrative ankimi është i lejuar”, neni 15 1. “Konflikti administrativ nuk mund të zhvillohet: 1.1. kundër akteve të nxjerra në çështjet, në të cilat është siguruar mbrojtja gjyqësore jashtë konfliktit administrativ; 1.2. kundër akteve të nxjerra në çështjet rreth të cilave, sipas dispozitës së ligjit nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ; 1.3. kundër akteve administrative, që përbëjnë një detyrim të përgjithshëm, të nxjerra nga organet e administratës, përveç kur ato cenojnë të drejtat e ligjshme të palëve”.

Në rastin konkret objekt kontesti është anulohet vendimi i KEDS-it, për kthimin e humbjeve prej 42.369 euro, dhe pasi që në konfliktin administrativ nuk mundet me qenë palë e paditur një person fizik apo juridik, i cili nuk paraqitet në cilësinë e organit të administratës shtetërore të nivelit qendror dhe lokal si dhe nuk kemi një vendim të organit administrativ i cili kontestohet me padi, sipas dispozitës së nenit 13.1 të Ligjit për Konfliktin Administrativ, atëherë në këtë çështje ka kompetencë lëndore dhe territoriale Gjykata Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm.

Në kuptim të arsyeve të sipër theksuara, Gjykata e Apelit vlerëson se Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, me të drejtë e ka hapur konfliktin e kompetencës në këtë çështje juridike kontestuese duke u bazuar në nenin 24 të LPK-së.

Nga të lartë cekurat e në pajtim me dispozitën e nenit 25 paragrafi 1 i LPK-së, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AN.nr.16/2024, me datë 05.03.2024

Kryetare e kolegjit
Delushe Halimi